



URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISE

Nr. 283 Prot.

VENDIM

Nr. 05, Dt. 12 / 12 / 2019

"Për miratimin e procedurës dhe metodologjisë kualifikuese për anëtar të Asamblesë Rajonale U.S.SH. Tiranë"

Në zbatim të vendimit nr.6 të Këshillit Kombëtar të U.S.SH., dt.25.09.2019 "Për ngritjen e komisionit zgjedhor me afat 6 mujor, për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve të reja për mandatin e dytë 2020-2025 të Urdhrit të Stomatologut" Komisioni zgjedhor,

Vendosi:

- Miratimin e procedurës dhe metodologjisë kualifikuese për anëtar të Asamblesë Rajonale U.S.SH. Tiranë.

- 1) Aplikimi me shkrim brenda datës 23.12.2019; ora 12.00
- CV personale;
 - Plotësimi dhe nënshkrimi i formularit "Tip" të miratuar nga komisioni për zgjedhjet në U.S.SH. .
- 2) Ftesa për intervistë para komisionit organizues; të zgjedhjeve, ditën e caktuar për intervistë, vlerësimi me rezultat kualifikues, 50% të pikëve maksimale;
- 3) Kualifikimi ndahet në dy kollona:
- Dosja personale që vlerësohet në bazë të kriterëve statutorë dhe atyre të kërkuara nga komisioni zgjedhor, vlerësimi maksimal me 100 pikë;
 - Intervista që vlerësohet deri në 100 pikë maksimale;
 - Kualifikimi i anëtarëve për në asamblatë rajonale duhet të sigurojë përfaqësimin sipas ndarjes administrative të njësive të qeverisjes vendore. Çdo stomatolog që plotëson kriteret statutorë bazë, konkuron për kuotat e përfaqësimit brenda njësisë administrative të qeverisjes vendore;
- 4) Njësitë administrative të qeverisjes vendore përfaqësohen nga 1-5 anëtarë në Asamblesë Rajonale Tiranë;



5) Nga e njëjta njësi nuk mund të kualifikohen më tepër sesa 5 anëtarë;

6) Çdo anëtar i komisionit ka të drejtën e vlerësimit nga 0-20 pikë, si për vlerësimin e dosjes ashtu dhe për vlerësimin e intervistës (0-20 pikë);

7) Numri i të kualifikuarëve në mënyrë përfundimtare, nuk duhet të tejkalojë numrin total të caktuar me vendim të veçantë nga komisionet e asambleve përkatëse rajonale:

- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Tiranë: të përfaqësohet nga 100 anëtarë;
- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Elbasan – Korçë: të përfaqësohet nga 45 anëtarë;
- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Fier – Berat: të përfaqësohet nga 45 anëtarë;
- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Vlorë – Gjirokastër: të përfaqësohet nga 40 anëtarë;
- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Shkodër – Kukës: të përfaqësohet nga 35 anëtarë;
- Asambleja Rajonale e U.S.SH. Lezhë – Dibër: të përfaqësohet nga 35 anëtarë;

8) Përgjigja përfundimtare jepet jo më vonë sesa 24 orë nga intervista;

9) Aplikanti mund të apelojë brenda 24 orësh me shkrim;

10) Përgjigja i kthehet apeluesit brenda 24 orësh. Përgjigja nga komisioni është e formës prerë dhe e paapelueshme;

11) Nga e njëjta poliklinikë dentare ose trung familjar nuk mund të kualifikohet më tepër sesa një anëtar (përfshihen nga ky rregull, të zgjedhurit e mandatit të parë të U.S.SH.);

12) Fakulteti i Mjekësisë Dentare (F.M.D.) është i garantuar sipas Ligjit 127/2014 dhe Statutit të U.S.SH., nenj 11, pika 1, përfaqësimi me 1 anëtar në Këshilli Kombëtar pa konkurim.

13) Sektori i stomatologjisë publike do të përfaqësohet me 3-5 veta në Asambleenë Rajonale Tiranë. Stomatologët që janë të zgjedhur në mandatin e parë edhe kanë patur performancë e kontribut të qënshëm e që nuk bien në kundërshtim me kriteret statutorë (sepse në mandatin e parë zgjedhjet u kryen në mungesë të Statutit pasi akoma nuk kishte një Statut të U.S.SH.) si dhe stomatologët e administratës qendrore të U.S.SH. janë direkt anëtarë të asamblesë rajonale. Nëqoftëse nuk ka aplikime për të patur nevojë për konkurim, komisioni është i detyruar të thërrasë në mënyrë aktive stomatologët për të marrë pëlqimin për tu anëtarësuar në asambletë rajonale, por gjithmonë duke plotësuar kriteret statutorë dhe ligjore.



14) Bashkia e Tiranës ka 27 njësi vendore administrative nga të cilat 11 kanë dendësinë më të madhe të shpërndarjes së klinikave dentare. Pjesë e Këshillit Rajonal të U.S.SH. Tiranë janë dhe Bashkia Kamëz dhe Vorë. Të gjitha këto njësi duhet të përfaqësohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe proporcionale në Asambleenë Rajonale të U.S.SH. Tiranë.

Asambleja Rajonale e U.S.SH. Tiranë do të përbëhet nga 100 anëtarë.

Vendimi u miratua me këtë numër votash: 5 Pro 0 Kundra 0 Abstenim

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni:

Kryetar: Alban Peca Alban Peca

Zv.Kryetar: Bledar Brati Bledar Brati

Sekretar: Orjeta Musabelli Orjeta Musabelli

Anëtar: Endrit Alia Endrit Alia

Anëtar: Aurela Guri AURELA GURI

